



**Agjencia e Punësimit
e Republikës së Maqedonisë**

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën e **stërvitjes për profesionet e kërkuara**, të financuar nga buxheti i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, më datën **28.03.2018** bën

SHPALLJE PUBLIKE

për personat e evidentuar si të papunë

1. U bëhet thirrje personave të evidentuar si të papunë, të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në stërvitjen për profesionet e kërkuara në tregun e punës, që të paraqiten në klubet e qendrave të punësimit ku janë të evidentuar si të papunë, më së voni deri më **10.05.2018**.

Stërvitjet do të mbahen nga ana e realizuesve të verifikuar dhe kanë të bëjnë me qytetet siç vijojnë:

- Gjipspunues-montues në Shkup, me arsim të mbaruar arsim fillor,
- Fasadëpunues në Shkup, Strumicë, me arsim të mbaruar arsim fillor,
- Pastrimin e oxhaqeve në Shkup me arsim të mbaruar arsim fillor.

2. Stërvitja do të mbahet në një periudhë prej tre muajsh, ndërsa pas mbarimit të saj kandidatët do të bëjnë një praktikë të përditshme në kushte reale të punëdhënësit në një kohëzgjatje prej një muaji, nëse si zbatues i stërvitjes janë dhomat ekonomike, dhomat zejtare dhe shkollat e mesme profesionale. Në qoftë se si zbatues të stërvitjes janë kompanitë private (punëdhënësit), atëherë punën praktike në një kohëzgjatje prej një muaji mund të mbajë tek e njëjta kompani private (punëdhënësi).

3. Personat e përfshirë do të marrin një pagesë prej 9.000,00 denarësh, duke përfshirë edhe tatimin personal për të ardhurat dhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale.

4. Personat e papunë të cilët do ta kryejnë stërvitjen, punën praktike dhe që do ta japin me sukses provimin e paraparë, do të marrin një certifikatë të lëshuar nga realizuesi i verifikuar stërviator.

5. Shfrytëzuesve të pagesës me të holla do t'u vazhdohet kjo e drejtë deri në përfundimin e stërvitjes, ndërsa shfrytëzuesit e ndihmës sociale do të vazhdojnë të marrin ndihmën me të holla gjatë stërvitjes.

6. Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Agjencisë së Punësimit të RM-së dhe kandidatëve të përzgjedhur.

7. Stërvitjet do të mbahen nëse do të ketë numër të mjaftueshëm të kandidatëve.

8. Në stërvitje nuk mund të marrin pjesë personat të cilët kanë qenë të përfshirë më parë në këtë masë.

Personat e papunë të cilët janë të interesuar mund t'i dorëzojnë fletëparaqitjet e tyre në qendrat e punësimit, çdo ditë prej orës 09:00 deri 14:00. Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, në telefonin 02/3111-850, si dhe në ueb faqet e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, www.avrm.gov.mk dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale www.mtsp.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË